



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.07.2025

Numër Protokoll: 4925/2025

A.nr.1131/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1131/2025, të datës 12.06.2025, të parashtruar nga ankuesja Sh.K kundër organit: Komuna e Suharekës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin nr. 1.1, nenin 16 paragrafin 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-08 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1131/2025, e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesja Sh.K.

II. Anulohet Njoftimi 01 Nr.016-27880, i datës 14.05.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, për shpalljen e rezultateve përfundimtare sipas konkursit me Nr. reference: RN00017129 për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë, dhe të gjitha veprimet deri në fazën e vlerësimit profesional të kandidatëve.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Suharekës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim të procedura të zhvillohet nga faza e vlerësimit profesional.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, Sh.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 12.06.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit 01 Nr.016-27880, të datës 14.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, për shpalljen e rezultateve përfundimtare sipas konkursit me Nr. reference: RN00017129 për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë, të shpallur nga Komuna e Suharekës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa kjo e fundit, me datë 16.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3965/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 12.06.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuses; Njoftimin e datës 14.05.2025 për rezultatet përfundimtare; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesën e datës 16.07.2025; Konkursin me Nr. reference: RN00017129 për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë; Autorizimin e datës 19.03.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin e datës 25.04.2025 për formimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Formularin e vlerësimit të kritereve për listë të ngushtë; Listën e verifikimit paraprak datë 24.04.2025; Njoftimin për testim me shkrim datë 30.04.2025; Njoftimin për intervistë me gojë datës 12.05.2025; Formularin e renditjes përfundimtare; Aplikacionin e datës 04.04.2025 të kandidatës E.M me dokumentacionin e bashkangjitur nga faqe 1-9; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për kandidatet E.M; Listën e pyetjeve të intervistës me gojë; testin me shkrim; Aplikacionin e datës 16.04.2025 të ankuses me dokumentacionin nga faqe 1-26; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për ankuesen.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuses, është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komuna e Suharekës, më datë 20.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017219, për Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë, klasa profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 21.03.2025 deri më datë 19.04.2025.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar njëzetë (20) kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, dhe sipas njoftimit për verifikim paraprak janë përfshirë gjashtëmbëdhjetë (16) kandidat në mesin e tyre edhe ankuesja.

Pas përfundim të fazave të vlerësimit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Suharekës, më datë 14.05.2026, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare, me kandidaten E.M me 87.4 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i testit dhe intervistës ka qenë subjektiv, Komisioni përkatës ka bërë shkelje sepse kandidatja fituese nuk e ka përvojën e punës, ndërsa nuk e ka marr parasysh kualifikimin e ankuses. Kërkon që pas shqyrtimit të kësaj procedure të aprovohet ankesë të anulohet konkursi.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislationit të shërbimit civil, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017219, për Grupi i përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë dhe si rrjedhojë nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit, ka konstatuar së për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Juridik dhe ekonomik (pavarësisht nga specializimi); Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 1 (një) vit përvojë punë në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë ssë lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- Nenit 39 paragrafi 1, 7, 8 dhe 9, është përcaktuar: *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.*

-Nenit 40 paragrafi 2, ku përcaktohet: *2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*

Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë:

- Nenit 7, është përcaktuar: *1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.*

- Nenit 8 është përcaktuar: *Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.*

- Nenit 20 paragrafi 2, është përcaktuar: *2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.*

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit i procedurës së pranimit sipas konkursit të cekur më lartë, konstaton se sipas Vendimit 01-Nr.410-24288 të datës 25.04.2025, të Kryetarit të Komunës së Suharekës, është themeluar Komisioni i Pranimit për vlerësimin profesional për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë, në përbërje: 1. D.SH, kryesues-H.G, zëvendësues, 2. A.B, anëtar-I.B, zëvendësues, 3. A.K, anëtare-S.K, zëvendësues, 4. F.K, anëtar-A.T, zëvendësues dhe 5. B.I, anëtar-M.S, zëvendësuese, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, si prova materiale ka marr akt emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit dhe sipas tyre konstaton se kryesuesi D.SH sipas Vendimit të datës 13.01.2025 është ushtrues detyre i Menaxherit të Burimeve Njerëzore, anëtarët A.B sipas akt emërimit mban pozitën Shef i Sektorit të Financave, A.K sipas akt emërimit mban pozitën Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta, F.K sipas akt emërimit mban pozitën Udhëheqës i Prokurimit dhe B.I sipas akt emërimit mban pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë.

Kolegji ka konstatuar se pjesë e Komisionit të Pranimit nuk ka asnjë nëpunës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, ngase të gjithë anëtarët e komisionit të pranimit kanë pozita të kategorisë së ulët drejtuese, e për rrjedhojë duke pasur parasysh kriteret ligjore të papërcaktuar me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, konstaton se si anëtar të Komisionit të Pranimit duhet të jetë një asnjë nëpunës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale,, dhe sipas Kolegji të Këshillit, anëtarët e tjerë nuk mund të mbulojnë edhe këtë aspekt.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, dhe nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh që komisioni i pranimit nuk ka qenë i themeluar sipas kriterëve ligjore, atëherë edhe procedura e vlerësimit të kandidatëve testit me shkrim dhe intervistës me gojë, është e pavlefshme, andaj si rezultat i kësaj Njoftimi 01 Nr.016-27880, i datës 14.05.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, për shpalljen e rezultateve përfundimtare sipas konkursit me Nr. reference: RN00017129 për pozitën Zyrtar për Regjistrimin dhe Menaxhimin të Dhënave të Tatimit në Pronë, , është i pavlefshëm dhe si i tillë nuk mund të prodhojë pasoja juridike, andaj duke marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në pretendimet tjera të ankuesit, e për rrjedhojë duke marr parasysh dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Suharekës, të ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim të procedura të zhvillohet nga faza e vlerësimit profesional të kandidatëve.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.1131/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Sh.K;*
- *Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqëses të Njësisë së Birimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*